

# PËRFSHIRJA E AFTËSISË SË KUFIZUAR DUHET TË MBETET NJË PËRPARËSI PËR KOMPANITË, GJATË DHE PAS PANDEMISË COVID<sup>1</sup>

(International Labour Organization-ILO)

Personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një larmi të gjerë talentesh dinamike, inovative, thelbësore për zhvillimin e ndërmarrjeve që kanë vizion. Sidoqoftë, ata janë gjithashtu një nga grupet më të ndikuara nga pandemia e COVID-19.

Edhe para krizës aktuale, personat me aftësi të kufizuara janë përballur me pengesa në tregun e punës dhe ata po përballen edhe me më shumë pengesa gjatë krizës, për të fituar ose mbajtur punësimin. Kjo është veçanërisht rasti për punëtorët të cilët përballen me diskriminim për shkak të aftësisë të tyre të kufizuara, së bashku me rrethanat e tjera ndërhyrëse, siç janë mosha, gjinia, raca, etnia dhe orientimi seksual. Ne pajtohemi me gjithë zemër me Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara kur ai thotë se strategjia ndaj pandemisë duhet të jetë përfshirëse e aftësisë së kufizuar. Ne pajtohemi me gjithë zemër me Drejtorin e Përgjithshëm të ILO kur ai thotë se një përgjigje gjithëpërfshirëse e aftësisë së kufizuar është një përgjigje shumë më e mirë për të gjithë. Ne jemi të vetëdijshëm se koha për veprim është tani, që përfshirja e aftësisë së kufizuar nuk mund të vonohet gjatë krizës COVID, sepse veprimi i vonuar do të ishte vetëm një recetë për të rikthyer të njëjtat pabarazi si më parë, gjë që mund të thellojë marginalizimin tashmë të ballafaquar nga shumë persona me aftësi të kufizuara.

Për këtë arsye kompanitë duhet:

- Të pranojnë se aftësia e kufizuar është një fakt i jetës, një shprehje e diversitetit dhe se përfshirja e aftësisë së kufizuar është një forcë e biznesit të mirë, dhe duhet të vlerësohet gjatë dhe pas krizës aktuale;
- Të riafirmojnë angazhimin e tyre për të promovuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara, duke ndjekur parimet e Kartës Globale të Biznesit dhe Aftësisë së Kufizuar dhe duke siguruar që masat e marra për adresimin e pandemisë të zbatohen në një mënyrë jo-diskriminuese;
- Të riafirmojnë nevojën për bashkëpunim midis të gjithë aktorëve të interesuar (autoritetet publike, partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile, përfshirë organizatat e personave me aftësi të kufizuara) për të promovuar bashkërisht punësimin e personave me aftësi të kufizuara përmes një kombinimi të masave jo-diskriminuese dhe të veprimit pohues;
- Të theksojnë nevojën për përgjigje kombëtare socio-ekonomike të pandemisë për të përfshirë personat me aftësi të kufizuara si një grup përparësor dhe për të ndërmarrë të dy masat e synuara dhe për të siguruar përfshirjen e tyre në masat kryesore;
- Të mbështesin konsultim dhe dialog domethënës me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, me vëmendje të veçantë ndaj grupeve më të marginalizuara, në mënyrë që njohuritë dhe përvoja e tyre të na drejtojnë të gjithëve në rindërtimin e një shoqërie më të drejtë;
- Të përkushtohen për të komunikuar këtë Deklaratë brenda organizatave të tyre, palëve të tyre të interesit, partnerëve të tyre dhe shoqërisë më të madhe në të cilën ne të gjithë jetojmë dhe punojmë.

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.